




MUHAMMEDI (S.A.S)







MUHAMMEDI (S.A.S)



Kush është Muhammedi (s.a.s)?

Në vitin 570, në qytetin e Mekkes i ndodhur në Gadishullin Arabik, një familje me prejardhje nga Pejgamberi Ibrahim (a.s.) sjell në jetë një fëmijë. Emri i fëmijës ishte Muhammed, që do të thotë i lavdëruar. Ai i kuptonte mirë jetimët dhe njerëzit që jetonin në kushte të vështira, pasi edhe vetë kishte mbetur jetim që në moshë të vogël. Kur u rrit, Muhammedi u bë një i ri me karakter të lartë. Allahu i Madhëruar e ruajti atë prej stilit të jetesës së arabëve të kohës së xhahilijetit (inJORANCËS paraislame), ku ishin të përhapura veset e këqija si: pijet alkoolike, imoraliteti (zinaja)

dhe vjedhja. Njerëzit i linin emanet atij sendet e tyre me vlerë, shoqëria e përkufizonte atë si një njeri besnik (el-Emin). Muhammedi (s.a.s.) interesohej për problemet e shoqërisë ku jetonte, ai përpiquej të ndërtonte një shoqëri të virtytshme edhe para se të zgjidhej pejgamber. Një shembull për këtë është përpekja e tij për të parandaluar zullumin ndaj tregtarëve të huaj.

Pejgamberillëku

Kur arrin moshën 40 vjeçare, Muhammedi (s.a.s.) merr shpalljen e parë nga Allahu nëpërmjet Xhebrailit (a.s.), në muajin Ramazan, muaji i nëntë i vitit, sipas kalendarit hixhri. Mesazhi i parë që iu shpall atij ishte: “Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë).” Në këtë mënyrë, Islami që do të predikonte Muhammedi (s.a.s.), që nga fillimi i tij i jep rëndësi nxënies së dijes dhe shpërndarjes së saj.

Muhammedit (s.a.s.) vijoi ti vijë shpallja përgjatë një periudhe prej njëzet e tre vitesh me rradhë. Ky mesazh, i cili nga ana e Allahut të Madhëruar u quajt “Kur’an”, i drejtohet mbarë njerëzimit me këtë princip bazë: *Të besohet Allahu si Krijuesi vetëm, Melekët e Tij, Pejgamberët*

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

عن علي رضي الله عنه قال
كان أبا وصفا النبي صلى الله عليه وسلم قال
فريضة من أظلم بالتمط ولا بالفضة للزود كان نبي
من القوم ولو يكن أبعد الفطط ولا بالكم كان
جعداً رجا ولا يكر بالظهور ولا بالسط وكان في الزود
نذير أيض مشرر أذبح العيش أهدب لأشع
جليل المشاش والكد الأزد مؤسره شتر الكفين
والقد من إذا مشى بكم كما يمشي في صلب
وأوال الفضة الفضة مع

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

بَرَكَاتٍ فِيهَا خَيْرٌ النَّبِيُّ هُوَ حَامٍ النَّبِيِّ أَجْرُ النَّاسِ
صَدْرًا وَأَمْدَهُ فُهُمْ هُيَ وَالْيَهُ عَرَبِيَّةٌ وَأَكْمَهُ عَشْرَةٌ
مَنْ سَرَاهُ هَابَةٌ وَمَنْ خَالَطَهُ مَفْرَهَةٌ أَسْبَهُ يَقُولُ نَاعِيَهُ لَوْ أَدْفَنِيَهُ
وَلَا بَعْدَهُ وَمَنَّهُ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ اللَّهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلَى عِبْرِ الزَّمَانِ
وَسَبِّحْ أَلَامَهُ وَتَجَرَّ وَالدُّوْحِيَّةُ الْجَمْعِيَّةُ مَسْمُومَةُ حَسْبُهُ غَيْرُ لَهُ



e Tij, Librat e Tij, Jeta e Ahiretit, si dhe Kaderi dhe Kadaja (çaktimi i Allahut të madhëruar se do të ndodhë patjetër).

Përgjatë trembëdhjetë viteve të para të pejgamberllëkut të tij, Muhammedi (s.a.s.) i fton njerëzit që të distancohen nga adhurimi i idhujve dhe të adhurojnë vetëm Allahun. Njeriu i parë që i besoi ishte bashkëshortja Hatixhe, e cila quhet ndryshe edhe “nëna e muslimanëve”. Ndërsa Muhammedi (s.a.s.) zhvillonte thirrjen e tij, mekasit e shihnin atë si një kërcënim për stilin e tyre pagan të jetesës. Sa herë që bënte thirrje për të drejtat e të dobtëve, tërhiqte mbi vete urrejtjen dhe mllefin e të fortëve, por megjithatë, qëndroi gjithmonë përkrah të të varfëve dhe atyre që iu bëhej padrejtësi.

Ata provojnë çdo rrugë, si ryshfetin, torturën, bojkotin etj, për ta bërë atë të tërhiqet nga ky besim. Pas të gjitha këtyre vuajtjeve, muslimanët nuk e braktisën Islamin. Në vitin 622, Allahu e urdhëron Muhammedin (s.a.s.) të bëjë hixhret (të emigrojë) për në Medine, një qytet në veri të Mekkes. Hixhreti është aq ngjarje e rëndësishme, sa që u bë pika fillestare e kalendarit të muslimanëve. Muslimanët, u bënë një shoqëri që jetonte në harmoni në Medine. Shumë njerëz, me prejardhje



سوره



۱۴۲۷

P. Shafiq, Designer
2019

të ndryshme fetare, fisnore dhe racore, pranojnë Islamin, në atë qytet. Njerëz të shtresave të ndryshme u ndikuan nga personaliteti i lartë dhe thjeshtësia e Pejgamberit (s.a.s.).

Në vitin e tetë të hixhretit, Muhammedi (s.a.s), kthehet në Mekke me një ushtri prej 10.000 vetash, me urdhërin që të mos derdhet gjak dhe të mos ketë hakmarrje. Ai hynë në qytetin e Mekkes, hipur mbi deve, me një thjeshtësi të plotë, me kokën ulur, aq sa përpak po prekte qafën e deveve dhe iu drejtua njerëzve me këto fjalë: *“Ju them juve sot, atë që i tha Jusufi vëllezërve të tij: ‘Sot nuk ka qortim kundër jush, Allahu ju faltë juve’, jeni të lirë”*.

Pas një viti, në kohën e haxhit, mban hutben e lamtumirës dhe i drejtohet sahabeve, ummetit dhe mbarë njerëzimit, për herë të fundit, me këto fjalë:

“Çdo zakon i trashëguar nga xhahilijeti [periudha paraislame] është shfuqizuar. Ndërpritni çdo lidhje që keni me kamatën. Mos beni padrejtësi dhe mos lejoni t’ju bëjnë padrejtësi. Nuk ka epërsi arabi mbi joarabin, as joarabi mbi arabin; as i bardhi mbi të ziun, as i ziu mbi të bardhin. Epërsia tek Allahu i madhëruar matet vetëm sipas devotshmërisë [takvasë]. Që nga ky moment idhujtaria ka marrë fund...”

لِاَللّٰهِ اَوْلٰىكَ الْاَدِيْرَ اَمْتَحَنَ اللّٰهُ قُلُوْبَهُمْ لِلنَّبِيِّ
رَمَةً وَّاجْرٌ عَظِيْمٌ

هَذَا الْمَسْلُوكُ
سِرُّ اَللّٰهِ

وَحُجْرَةُ النَّبِيِّ

اَللّٰهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلٰى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ
وَعَلٰى اٰلِهِ وَاَصْحَابِهِ
وَعَلٰى اُمَّةٍ اَمَّتْ اَعْلٰى دَرَجَاتِ
الْاَرَضِ وَالْاَسْمٰوَاتِ
وَعَلٰى اَمَّةٍ اَمَّتْ اَعْلٰى دَرَجَاتِ
الْاَرَضِ وَالْاَسْمٰوَاتِ
وَعَلٰى اُمَّةٍ اَمَّتْ اَعْلٰى دَرَجَاتِ
الْاَرَضِ وَالْاَسْمٰوَاتِ
وَعَلٰى اُمَّةٍ اَمَّتْ اَعْلٰى دَرَجَاتِ
الْاَرَضِ وَالْاَسْمٰوَاتِ





Në keto momente i zbritet ky ajet: “Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe...” [Maide: 3].

Muhammedi [s.a.s.] ndërron jetë në vitin 632 dhe varroset në qytetin e Medines, në Arabi.

Veçoritë Morale



Si një njeri me sjellje të thjeshtë, ai nuk fliste ashpër dhe me fjalë të papërshtatshme. Kur ndodhej përballë një dukurie të shëmtuar, negative apo të pamoralshme, largohej prej aty ose e urrente atë. Asnjëherë nuk e ngrinte zërin, të keqen që i bëhej nuk e kthente me të keqe. Motoja e tij ishte mos bëni padrejtësi, por as mos lejoni t'ju bëjnë padrejtësi. Asnjëherë nuk ka kundërshtuar urdhërat e Allahut. Kur i jepej mundësia për të zgjedhur, zgjidhte më të lehten, përse kohë nuk ishte në kundërshtim me vullnetin e Allahut. Ishte aq i thjeshtë sa që gatuate në shtëpi dhe ndihmonte në pastrimin e saj. Fliste vetëm në lidhje me çështjet që kishin të bënin me të. Sillej me thjeshtësi me njerëzit dhe bënte që ata të ndiheshin të qetë pranë tij. Çdo gjë që posedonte, e ndante me të tjerët me bujari. Ishte i ekuilibruar. Kur ishte i ulur nuk çohet asnjëherë para mysafirëve dhe nuk largohej para se të largoheshin ata. Ishte i durueshëm ndaj atyre që e mundonin duke i shkaktuar vështirësi. Prandaj, gjithkujt i pëlqente që të gjendej

në një ambjent me të. Ishte shumë i dhembshur, nuk ishte kurrë i ashpër dhe as lakmitar. Nuk e pranonte në asnjë mënyrë lëvdatën që nuk e meritonte.

Riformatimi i Shoqërisë



Muhammedi (s.a.s.) beri të mundur që në shoqëri të ndodhnin ndryshime të mëdha:

- Ishte mbrojtës i të drejtave të femrës. Anulloi “pronësinë” e burrit mbi bashkëshorten. I dha femrës të drejtën e pronës dhe trashëgimisë, si dhe të drejtën e zgjedhjes së bashkëshortit apo të refuzimit të kandidatit për bashkëshort.
- Ishte mbrojtësi i jetimëve dhe mundësoi mirësjelljen e njerëzve ndaj tyre. Ja njëri prej haditheve më të përhapura: *“Shtëpia më e mirë është ajo shtëpi brenda së cilës ka mirësjellje ndaj jetimit, ndërsa shtëpia më e ligë është ajo shtëpi brenda së cilës keqtrajtohet një jetim.”*

- Muhammedi [s.a.s.] ishte mik i mjedisit. Për shembull, sa herë që bënte pushim gjatë një udhëtimi, ngarkonte dikë prej sahabeve që të mblidhte mbetjet, para se të largoheshin.
- Ka ndaluar që kafshët të mbingarkohen dhe ka porositur që të sillemi me mëshirë ndaj çdo kafshe.
- Njerëzit rreth tij i mësonte që ta duan dhe ta mbrojnë natyrën, i ka urdhëruar ata që të mbjellin pemë qoftë edhe ditën kur po ndodh kijameti. Ka ndaluar që të dëmtohet natyra, sidomos pemët, edhe në luftë e sipër.
- Ka treguar interes të madh për shëndetin e shoqërisë. Ka punuar për të asgjësuar alkoolin, lëndët narkotike, skllavërinë dhe bixhozin [kumarin].



Kontakt:
Kryesia e Çështjeve Fetare
Drejtoria e Përgjithshme e Botimeve Fetare
Departamenti i Botimeve në Gjuhët e Huaja dhe Dialektet

Diyanet İşleri Başkanlığı
Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü
Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı
No:147/A 06800 Çankaya-ANKARA/TÜRKİYE

Tel : +90 312 295 72 81

Fax : +90 312 284 72 88

e-mail: yabancidiller@diyanet.gov.tr

H.z. MUHAMMED (s.a.s.)

ARNAVUTÇA